



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:285479

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05396979

KPPP.nr.969/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbarimore të kreditorit Shoqëria Tregtare “Korporata Prodhuese Tregtare dhe Shërbyese Gascom” Sh.P.K., me seli në Gjilan, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit M.F.N. avokat nga Gjilani Rr.”Bulevardi i Pavarësisë” p.n. hyrja I-rë, nr.2, kundër debitorit Shoqëria Tregtare “Ex Fis” SH.P.K., me NUI:810536998, me seli në Prishtinë, Sheshi Bill Klinton, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.256/21, të datës 12.11.2021, të Përmbaruesit Privat Përparim I. Xhelili me seli në Gjilan, jashtë seancës me datën 29.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET POSHTË si i pa afatshëm prapësimi i debitorit Shoqëria Tregtare “Ex Fis” SH.P.K., me NUI:810536998, i ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.256/21 të datës 12.11.2021 të Përmbaruesit Përparim I. Xhelili.
- II. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve të procedurës përmbarimore për përpilimin e përgjigjes në prapësim të ia paguaj kreditorit shumën prej 208.00 € (dy qind e tetë euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat Përparim I. Xhelili, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Shoqëria Tregtare “Korporata Prodhuese Tregtare dhe Shërbyese Gascom” Sh.P.K., me datën 12.11.2021, ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.256/21, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të aktit noterial Kontratë për qira Tokës dhe Pompes Benzines me Nr.Rend:1626/2020, Nr.Ref.228/2020 e datës 04.03.2020, duke detyruar debitorin që të paguaj borxhin në emër të qirasë t’ia paguaj kreditorit shumën prej 93,456.00 euro, shpenzimet për përpilimin e propozimit në shumë prej 312.00 euro si dhe shpenzimet e

procedurës përbarimore me ndalim të mjeteve në para të cilat debitori i ka në të gjitha llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogaritë e kreditorit, si dhe regjistrimin, konfiskimin, dhe shitjen publike të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe nga shitja e këtyre të realizohet borxhi ndaj kreditorit si dhe të paguhen shpenzimet e procedurës përbarimore në pajtim me tarifat në fuqi.

Debitori ka parashtruar prapësim përmes të cilit e kundërshton urdhrin përbarimor, ndër të tjerash ka theksuar se dokumenti në bazë të cilit është marr urdhri përbarues, nuk përbën titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare të përbarueshmërisë dhe se kreditori nuk është i autorizuar të kërkojë përbarimin në bazë të dokumentit përbarues, gjegjësisht ai nuk është i autorizuar të kërkojë përbarimin kundër debitorit, po ashtu përbaruesi që ka lëshuar urdhrin për përbarim nuk është kompetent. Tutje ka theksuar se dokumenti përbarimor mbi të cilin mbështetet urdhri i atakuar nuk ka tipare të përbarueshmërisë për shkak se në të nuk janë precizuar, objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit si dhe as në dokumentin përbarues dhe as në propozimin për përbarim nuk është caktuar afati për përmbushje vullnetare. I ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar dhe të anulohet urdhri përbarimor.

Kreditori në përgjigje në prapësim të ushtruar brenda afatit ligjor, i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, ndër të tjerash ka theksuar se konsideron se kundërshtimet e paraqitura nga debitori për sa i përket pengesave të pretenduara në procedimin e çështjes nga organi përbarues, pretendimet e shprehura lidhur me prapësimet procedurale dhe prapësimet materialo- juridike nuk janë fakte juridike nga të cilat varet zbatimi i normave të procedurës përbarimore në këtë çështje. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pa themeltë prapësimi i debitorit dhe të debitori që t'ia paguaj shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është i pa afatshëm për arsyet si në vijim:

Sipas vlerësimit të Gjykatës, debitori Urdhrin Përbarimor P.nr.256/21 të datës 12.11.2021, të Përbaruesit Privat Përparim I. Xhelili, e ka pranuar me datë 16.11.2021, e cila vërtetohet nga fletë kthesa për dorëzim personal të përbaruesit privat që gjendet në shkresat e lëndës, ndërsa prapësimi nga ana e debitorit është ushtruar me datën 01.12.2021.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore përcaktohet se *“Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbareues ose urdhrin përmbareues”*, ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se *“Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.”*

Andaj duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret debitori urdhrin përmbaremor P.nr.256/21 të datës 12.11.2021, e ka pranuar me datën 16.11.2021, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimin ka filluar të rrjedhë nga data 17.11.2021, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimin ka qenë data 23.11.2021.

Meqenëse në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 01.12.2021, në zyrën e përmbareuesit privat, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar edhe në mënyra tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me tetë ditë vonesë.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbaremore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 par.2 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumën prej 208.00 €, siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifën e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 73 par.3 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.969/22, datë 29.02.2024

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.